# VENDIM

i ortakut te vetem

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "DIAN-TIR" eshte regjistruar si person juridik me vendimin nr.19581 date 09.06.1998 te gjykates shkalles pare Tirane, me ortak te vetem dhe administrator Roberto Gjani, me kapital themeltar 100.000 leke. Sot ne daten 15.12.2002 une ortaku i vetem i shoqerise "DIAN-TIR" pasi shqyrtova veprimtarine dhe situaten ekonomiko-financiare te saj vendosa te kaloj ne operacionin e bashkimit me shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "MAT-EDIL" regjistruar person juridik me vendimin nr.20231 date 03.11.1998 te gjykates shkalles pare Tirane, aktualisht me ortaket Roberto Gjani dhe Resul Çarçani. Te prish palikujdim shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "DIAN-TIR" dhe te kaloj kapitalin e saj te drejtat, detyrimet ne shoqerine "MAT-EDIL" ne gjendjen qe jane ne daten e realizimit perfundimtar te operacionit te bashkimit. Te futem ortak ne shoqerine "MAT-EDIL". Ne operacionin e bashkimit shoqeria "MAT-EDIL" te jete perthithsja dhe shoqeria "DIAN-TIR" te jete e perthithura. Operacioni te realizohet ne baze te projektit te bashkimit hartuar per bashkimin e shoqerise "MAT-EDIL" me shoqerine "DIAN-TIR". Ne bisedimet perfundimtare me organin vendimore te shoqerise "MAT-EDIL" eshte pergatitur projekti i bashkimit te shoqerive.

Mbeshtetur ne aktin e themelimit, ne statutin e shoqerise si dhe ne nenet 243,244,245,248 te ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjin 7667 date 28.1.1993 "Per regjistrin tregtar",

## VENDOSA:

1.Te filloj operacionin per bashkimin e shoqerise "DIAN-TIR" me shoqerine "MAT-EDIL" ne formen e perthithjes nga shoqeria "MAT-EDIL".

Me perfundimin e operacionit te bashkimit te prish palikujdim shoqerine "DIAN-TIR" te futem ortak ne shoqerine "MAT-EDIL", te kaloj kapitalin themeltar te shoqerise "DIAN-TIR" te gjitha te drejtat dhe detyrimet ne shoqerine "MAT-EDIL" ne gjendjen ne te cilen ndodhen ne daten e realizimit te operacionit perfundimtar te bashkimit.

3. Te pranoje qe pas perfundimit te operacionit te bashkimit une Roberto Gjani te jem ortak me Resul Çarçanin ne shoqerine me pergjegjesi te

kufizuar "MAT-EDIL". Kapitali themeltar i shoqerise "MAT-EDIL" pas bashkimit me kapitalin e shoqerise "DIAN-TIR" pranoj te jete 200.000 leke i ndare midis ortakeve nga 100.000 leke secili.

4. Data e bashkimit per efekt te veprimeve financiare te jete 31 dhjetori i vitit 2002 e cila perkon me daten e mbylljes se bilanceve te dy shoqerive.

5.Te miratoj projektin e bashkimit dhe bashkelidhur me kete vendim te depozitohet ne regjistrin tregtar te gjykates shkalles pare Tirane.

6.Te caktoje ekspert kontabel te autorizuar z.Qani Kajo per te hartuar raportin me shkrim mbi modalitetet e bashkimit.

7.Te depozitohet ne zyren e regjistrit tregtar te gjykates shkalles pare Tirane ky vendim i ortakut te vetem dhe projekti i bashkimit.

ORTAKU I VETEM

Roberto Gjani

"MAT EDIL..Sh p k"
Rr. Durrësit TIRANË
NIPT J 62302001 C
Nr. Liç. 3707748

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
Nr.2227rep
Nr..-...kol

VERTETIM

Sot me daten 26.12.2002, para meje noteres Marieta Brisku u paraqite personalisht Roberto Gjani per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta. Ai eshte madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, dhe deklaroi sa me siper eshte shkruar sipas vullnetit te tij te lire dhe te plote nenshkroi vendimin e ortakut te vetem para meje dhe une noterja u vertetoj firmen sipas ligjit.

NOTERE
Marieta Brisku